

# **MANUALI: PËRMBAJTJA NË GJUHËT E PAKICAVE NË TRANSMETUESIT PUBLIK TË MALIT TË ZI**

**Podgoricë, qershor 2022**

**Emri i manualit**  
**PËRMBAJTJA NË GJUHËT E PAKICAVE NË TRANSMETUESIT PUBLIK TË MALIT TË ZI**

**Botues:**



**Për botuesin:**

Millan Radoviq

**Autor:**

Igor Llakiq

Ky projekt është mbështetur nga:



Fond za zaštitu i ostvarivanje  
manjinskih prava

Qëndrimet e shprehura në këtë publikim nuk  
përfaqësojnë medoemos pikëpamjet e donatorit

**Përktheu:**

Bernard Çobaj

**Përkujdesja grafike:**

AP Print

**Shtypur në:**

AP Print

**Tirazh:**

100 kopje

## Përmbajtja:

I	INFORMACIONE PARAPRAKE .....	4
II	PËRMBAJTJA NË GJUHËT E PAKICAVE.....	7
	a) Gjuhët dhe mediat e pakicave .....	7
	b) Mediat e reja .....	7
III	KARTA EVROPIANE PËR GJUHËT RAJONALE OSE TË PAKICAVE DHE MEDIAT PUBLIKE NË MAL TË ZI	10
IV	SITUATA AKTUALE ME GJUHËT E PAKICAVE NË TRANSMETUESIT PUBLIK DHE REKOMANDIMET PËR INFORMIM .....	11
	a) Gjuha shqipe .....	11
	b) Gjuha rome .....	12
	c) Gjuha boshnjake dhe kroate .....	12
V	REKOMANDIME TË PËRGJITHSHME.....	13

## I INFORMACIONE PARAPRAKE

Manuali që keni para jush është pjesë e projektit “Drejt respektimit më të mirë të së drejtës për përdorimin e gjuhës amtare të popujve pakicë në Mal të Zi”. Projekti u mbështet nga Fondi për Mbrojtjen dhe Realizimin e të Drejtave të Pakicave.

Qëllimi i përgjithshëm i projektit është të kontribuojë për ruajtjen dhe zhvillimin e identitetit nacional, fetar, gjuhësor dhe etnik të popujve pakicë në Mal të Zi, kurse qëllimi specifik është sensibilizimi për të drejtat e pakicave nëpërmjet fuqizimit të kapaciteteve të transmetuesve lokal dhe publik dhe përcaktimit të të dhënave të sakta për përdorimin e gjuhëve amtare të popujve pakicë në përmbajtjet programore të transmetuesve publikë në nivel nacional dhe lokal.

Në qershor të vitit 2019, Qeveria e Malit të Zi e miratoi Strategji e re për Politikën e Pakicave (2019-2023), e cila ndër të tjera parashikon zbatimin e aktiviteteve, siç janë: Promovimi dhe zbatimi i zgjidhjeve pozitive ligjore në fushën e përdorimit të gjuhës dhe shkrimit të pjesëtarëve të popujve pakicë dhe komuniteteve të tjera të pakicave nacionale në nivel lokal. Gjithashtu, Strategjia njohu edhe qëllimin strategjik: Krijimin e një sistemi efektiv të monitorimit të realizimit të të drejtave të popujve pakicë dhe komuniteteve të tjera të pakicave nacionale në Mal të Zi dhe sensibilizimin e tyre për statusin, të drejtat dhe detyrimet e tyre në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe të drejtën pozitive të Malit të Zi. Përveç kësaj, Ligji për Mediat Elektronike përmban dispozita për programe në gjuhët e pakicave dhe programe që merren me interesat e komuniteteve pakicë. Ligji parashikon që përveç në gjuhën malazeze si gjuhë zyrtare, përmbajtja dhe programet duhet të prodhohen në gjuhët e popujve pakicë dhe se transmetuesit janë të detyruar të prodhojnë programe të tilla. Gjithashtu, mjetet për programet që synojnë ruajtjen e "identitetit kulturor dhe etnik" të komuniteteve pakicë duhet të sigurohen nga buxheti i Malit të Zi ose i njësisë së vetëqeverisjes lokale, veçanërisht për transmetimin në gjuhën rome dhe shqipe. Komiteti Këshillimor për Konventën Kuadër për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare miratoi Opinionin e tretë për Malin e Zi, në të cilin inkurajon Malin e Zi që të vazhdojë të bëjë përpjekje për të informuar publikun përmes mediave për historinë dhe kulturën e popujve pakicë. Ka pak hulumtime në këtë fushë dhe është e nevojshme të kontrollohet situata në terren. Në vitin 2009, OJQ Nisma Rinore për të Drejtat e Njeriut publikoi raportin e saj të parë për periudhën 2006-2009, në të cilin hulumtoi të drejtat e pakicave me fokus në të drejtën për përdorimin zyrtar të gjuhës amtare, të drejtën për informim në gjuhën amtare, të drejtën për arsim, të drejtën për përfaqësim proporcional.

Prandaj, ne besojmë se manuali do t'i ndihmojë transmetuesit publikë të përmirësojnë përmbajtjen e tyre programore në gjuhët e popujve pakicë dhe të komuniteteve të tjera të popujve pakicë, si dhe përmbajtjen programore që flasin për kulturën, traditën dhe zakonet e popujve pakicë.

Ftojmë mediat që të miratojnë dhe zbatojnë në praktikë rekomandimet e projektit, si dhe udhëzimet dhe rekomandimet tjera që vijnë nga institucionet dhe organizatat e ndryshme nacionale dhe ndërkombëtare, dhe në këtë mënyrë të sigurojnë rezultatet e përhershme në formën e krijimit të kapaciteteve për realizimin e përmbajtjeve programore në gjuhët e pakicave.



## II PËRMBAJTJA NË GJUHËT E PAKICAVE

Mali i Zi njihet si një vend ku jetojnë anëtarë të grupeve të ndryshme nacionale, etnike dhe fetare. Në të njëjtën kohë, Mali i Zi është një shoqëri shumëgjuhëshe në të cilën përveç malazezsishtes, e cila është gjuha zyrtare e shtetit, si gjuhë në përdorim zyrtar fliten edhe serbishtja, boshnjakishtja, kroatishtja, shqipja dhe romishtja. Megjithatë, derisa serbishtja, boshnjakishtja dhe kroatishtja i përkasin të njëjtit sistem gjuhësor si malazezsishtja dhe janë reciprokisht tërësisht të kuptueshme, shqipja dhe romishtja përfaqësojnë gjuhë krejtësisht të ndryshme.

Përveç Kushtetutës, e cila përcakton gjuhën malazeze si gjuhë zyrtare dhe gjuhët e tjera si gjuhë në përdorim zyrtar, Mali i Zi është gjithashtu nënshkrues i Kartës Evropiane për Gjuhët Rajonale ose të Pakicave. Me nënshkrimin e Kartës, Mali i Zi vendosi të mbrojë gjuhën shqipe, rome, boshnjake dhe kroate si gjuhë të pakicave. Shteti ofron mbrojtje të detajuar për gjuhën shqipe dhe rome, dhe mbrojtje e promovim të përgjithshëm për gjuhën boshnjake dhe kroate. Kjo mbrojtje përfshin kryesisht edhe praninë e këtyre gjuhëve në media.

Situata e përshkruar këtu i referohet transmetuesve publikë dhe nuk përfshin situatën në mediat private.

### a) Gjuhët dhe mediat e pakicave

Sot, media ka një ndikim në rritje në të gjitha aspektet e jetës sonë. Zhvillimi i teknologjisë mundëson që ndikimi i mediave të jetë më i madh se kurrë më parë. Megjithatë, me rritjen e sasisë së informacionit, disa çështje, si mbrojtja e gjuhëve rajonale dhe të pakicave, mund të bien në plan të dytë. Gjuhët e pakicave përfaqësojnë një temë që nuk tërheq një audiencë të madhe, kurse mediat nga ana tjetër e marrin numrin e shikuesve dhe dëgjuesve të programeve të tyre si faktor vendimtar për arritjen e shikueshmërisë apo dëgjueshmërisë më të madhe. Në këtë aspekt, gjuhët e pakicave kanë nevojë për mbështetje publike, duke përfshirë mbështetjen e transmetuesve publikë.

Duhet pasur parasysh se transmetuesit, veçanërisht transmetuesit publikë, janë një nga aspektet kyçe të mbrojtjes së gjuhëve rajonale dhe të pakicave, duke qenë se asnjë gjuhë nuk mund të ketë ndikim të rëndësishëm, madje as të mbijetojë në kushtet e sotme, pa praninë e saj në media.

### b) Mediat e reja

Hartimi i Kartës Evropiane përfundoi në fillim të viteve nëntëdhjetë të shekullit të kaluar, kur

ekzistonte teknologjia analoge e transmetimit të sinjalit dhe mediat e shkruara tradicionale. Mirëpo, ndërkohë u shfaqën teknologji të reja, interneti dhe mediat sociale, të cilat ndryshuan vetë median dhe modelet e komunikimit dhe transmetimit të informacionit. E gjithë kjo ka një ndikim të madh në praninë e gjuhëve të pakicave në media.

Edhe me teknologji të reja, është e vështirë të parashikohet se si do të jetë situata me teknologjitë digjitale në vitet në vijim, duke qenë se tani po kalojmë nëpër revolucionin e tretë digjital. Inteligjenca artificiale po përparon me një shpejtësi të madhe dhe kjo do të ndryshojë më tej mediat në një të ardhme jo shumë të largët. Në një kontekst të tillë, media do të vazhdojnë të ndryshojë, duke ndjekur tendencat e reja si në shoqëri ashtu edhe në teknologji, por roli i tyre në mbrojtjen e gjuhëve të pakicave do të vazhdojë të jetë jo vetëm i domosdoshëm, por ndoshta edhe vendimtar.





### III KARTA EVROPIANE PËR GJUHËT RAJONALE OSE TË PAKICAVE DHE MEDIAT PUBLIKE NË MAL TË ZI

Mali i Zi është anëtar i Kartës Evropiane për Gjuhët Rajonale ose të Pakicave në Këshillin e Evropës. Si një vend që ka ratifikuar Kartën, Mali i Zi ka marrë përsipër detyrime të caktuara në lidhje me gjuhët e pakicave në Mal të Zi, duke përfshirë detyrimet që lidhen me median.

Pjesa e dytë e Kartës në nenin 7 ofron mbrojtje të përgjithshme për të gjitha gjuhët që vendi i njeh si gjuhë të pakicave, por për gjuhë të caktuara, të cilat janë të ndryshme nga gjuha zyrtare, shteti ofron mbrojtje të detajuar edhe brenda Pjesës së tretë (nenet 8-14).

Mali i Zi ofron mbrojtje të përgjithshme bazuar në Pjesën e Dytë të Kartës (neni 7) për gjuhën boshnjake dhe kroate. Bëhet fjalë për promovimin dhe mbrojtjen e këtyre gjuhëve, që përfshin përdorimin e tyre si në jetën publike ashtu edhe në atë private. Përdorimi i gjuhëve në sferën publike nënkupton edhe përdorimin e tyre në media. Duke qenë se boshnjakishtja dhe kroatishtja i përkasin të njëjtit sistem gjuhësor si gjuha malazeze dhe serbe, kjo mbrojtje në media në Mal të Zi i referohet pjesërisht disa dallimeve gjuhësore, kryesisht në fushën e leksikut, të gjuhës boshnjake dhe kroate, por në masë më të madhe promovimit të karakteristikave nacionale dhe kulturore të folësve të gjuhës boshnjake dhe kroate.

Në bazë të Kartës, Mali i Zi, krahas kësaj mbrojtjeje të përgjithshme, ofron mbrojtje të detajuar edhe të gjuhës shqipe dhe rome bazuar në pjesën e tretë të Kartës (nenet 8-14), e cila përfshin praninë e këtyre gjuhëve të pakicave në mediat elektronike, e cila rregullohet nga neni 11 i Kartës. Mbrojtja e detajuar zakonisht i ofrohet gjuhëve që janë krejtësisht të ndryshme nga gjuha zyrtare e vendit.

Mali i Zi ka marrë një gamë të gjerë detyrimesh kur bëhet fjalë për përmbajtjen e mediave në gjuhët e pakicave. Kështu, shteti mori përsipër detyrimin që transmetuesit publik të ofrojnë programe radiotelevizive në gjuhën shqipe dhe rome, por edhe të nxisin programe radiotelevizive në radio dhe televizione private në këto dy gjuhë. Në të njëjtën kohë, Mali i Zi merr përsipër që interesat e folësve shqiptarë dhe romë të merren parasysh në organet që garantojnë lirinë dhe pluralizmin e medias. Shteti mori përsipër të ndihmojë edhe botimin e veprave audio-vizuale në këto dy gjuhë, si dhe botimin e gazetave në gjuhën shqipe dhe rome.

## IV SITUATA AKTUALE ME GJUHËT E PAKICAVE NË TRANSMETUESIT PUBLIK DHE REKOMANDIMET PËR INFORMIM

Në këtë pjesë do të shikojmë situatën aktuale me gjuhët e pakicave dhe do të japim rekomandime për të përmirësuar situatën dhe për t'i bërë gjuhët e pakicave më të dukshme në media dhe në jetën publike në përgjithësi.

### a) Gjuha shqipe

Sipas mendimit të Komitetit të Ekspertëve për Gjuhët Rajonale ose të Pakicave, prezenca e shqipes në media është e kënaqshme. Ditëve të punës Radio Televizioni i Malit të Zi (RTMZ) transmeton lajmet në gjuhën shqipe, kurse të shtunave emisionin "Mozaiku", një program kolazh që zgjat dyzet e pesë minuta. Edhe Radio Mali i Zi transmeton programe në gjuhën shqipe. Radio Televizioni Rozhajë ka programe edhe në gjuhën shqipe. Përveç kësaj, disa radio lokale, si Radio Bar (në gjuhën shqipe: Tivar), transmetojnë programe në gjuhën shqipe.

### Rekomandime

1. Emisionet si "Mozaiku" duhet të titrohen në gjuhën malazeze, në mënyrë që këtë program ta ndjekin edhe folësit e gjuhëve të tjera. Në këtë aspekt, RTMZ duhet të forcojë kapacitetin e tij të titrimit.
2. Përmbajtjet në programet që flasin për folësit e gjuhës shqipe, siç është emisioni "*Mostovi*", të cilat transmetohen në gjuhën malazeze, duhet të jenë edhe me titra në gjuhën shqipe. Në të njëjtën kohë, programet në gjuhën shqipe në këto programe duhet të jenë të titruara në gjuhën malazeze.
3. Në komunat ku popullsia shqiptare përbën 5% ose më shumë të popullsisë, transmetuesit publikë lokalë duhet të kenë programe edhe në gjuhën shqipe. Është standard që transmetuesit të kenë lajme ditore në gjuhën e pakicës, por dhe programe shtesë. Një shembull i mirë është prania e shqipes në RTMZ.
4. Programet në gjuhët e pakicave nuk duhet të jenë ekskluzivisht informative, por duhet të përfshijnë përmbajtje kulturore, muzikore, letrare, dramatike, për fëmijë dhe të tjera.

## b) Gjuha rome

Informimi në gjuhën rome është dukshëm i kufizuar për shkak të mungesës së gazetarëve. Emisioni "Savore" transmetohet dy herë në muaj në RTMZ, me kohëzgjatje prej njëzet e pesë minutash. Emisioni dhe titrimi bëhet nga vetëm dy punonjës të RTMZ. Gjuha rome është e pranishëm edhe në Radion e Romëve. Emisioni "Zëri i Romëve" në Radion e Malit të Zi në gjuhën rome nuk është transmetuar që nga dhjetori i vitit 2021. Ekziston edhe një portal "Romanet" që ofron përmbajtje për romët dhe herë pas here përmbajtja publikohet në gjuhën rome.

### Rekomandime

1. Të angazhohet një numër shtesë i gazetarëve për programet në gjuhën rome në RTMZ, veçanërisht në Radion e Malit të Zi
2. Të krijohen lajme dhe përmbajtje të tjera në gjuhën rome në RTMZ dhe në programet e transmetuesve lokalë në komunat ku jeton popullata rome
3. Përmbajtjet në programet që flasin për romët, siç është emisioni "Mostovi", të cilat transmetohen në gjuhën malazeze, duhet të jenë edhe me titra në gjuhën rome. Në të njëjtën kohë, programet në gjuhën rome në këto emisione duhet të jenë me titra në gjuhën malazeze

## c) Gjuha boshnjake dhe kroate

Ngjashmëritë midis gjuhës malazeze, boshnjake dhe kroate nuk paraqesin pengesa në kuptim. Përveç kësaj, gjuhët boshnjake dhe kroate janë të pranishme në mediat malazeze dhe në mediat nga Bosnja dhe Hercegovina dhe Kroacia që transmetohen në Mal të Zi përmes operatorëve kabllorë.

### Rekomandim

1. Të përmirësohen programet që tregojnë kulturën dhe zakonet e boshnjakëve dhe kroatëve në Mal të Zi, duke përfshirë karakteristikat specifike gjuhësore të gjuhëve boshnjake dhe kroate

## V REKOMANDIME TË PËRGJITHSHME

- 1.** Programet në gjuhën shqipe dhe rome duhet të jenë të titruara në gjuhën malazeze dhe programet për shqiptarët dhe romët të shfaqura në gjuhën malazeze duhet të titrohen në gjuhën shqipe ose rome.
- 2.** Nëpërmjet programeve për pakicat dhe në gjuhët e pakicave, duhet të mundësohet informimi për gjuhën, zakonet, kulturën dhe aspekte të tjera të jetës së folësve të gjuhëve të pakicave. Popullsia shumicë duhet të ketë më shumë informacion për pakicat, gjë që kontribuon në arritjen e tolerancës më të madhe ndërgjuhësore dhe ndëretnike dhe uljen e distancës etnike.
- 3.** Duhet të sigurohet financim i qëndrueshëm i mediave dhe programeve që raportojnë në gjuhët e pakicave.
- 4.** Organet që garantojnë lirinë dhe pluralizmin e medias duhet të kenë parasysh interesat e folësve të gjuhës shqipe dhe rome.
- 5.** Prania e gjuhëve të pakicave duhet të sigurohet edhe në portalet e mediave publike, si dhe në rrjetet e tyre sociale.